

VENDIM
Nr. 57, datë 9.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR PERIUDHËN 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të nenit 16; 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 5 dhe 14, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a., për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017.

- ERE, me shkresën nr. 186/4 prot., datë 2.3.2018, u ka kërkuar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. të bëjnë me dije ERE-n mbi dispozitat në draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, për të cilat nuk gjejnë dakordësinë respektivisht të dyja kompanitë dhe ka kërkuar dhënien e argumenteve ligjore përkatëse.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në vijim, ka përcjellë në ERE shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, me anë të së cilës kërkon fillimin e menjëhershëm të procedurës për të konkluduar me nënshkrimin e kësaj draftkontrate, e cila do të zgjidhte mosmarrëveshjet e krijuara mes dy shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a., në shkresën e saj shprehet se pavarësisht korrespondencave të vazhdueshme me KESH sh.a. mbeten akoma të pazgjidhura pikat kyçe të saj që kanë të bëjnë me nominimet dhe penalitetet dhe, konkretisht, neni 4, “Të drejtat dhe detyrimet e blerësit”, neni 5, “Të drejtat dhe detyrimet e shitësit” dhe neni 9, “Zhdëmtimet/ kompensimet”.

- KESH sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018, ka përcjellë në ERE draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal /OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet

shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohej në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi